Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë

anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots + On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet

para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për

Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

(e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁵Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratur dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁵ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, janë përshkruar sa më saktë dhe plotësisht, për sa është mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator

specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara.

SPECIFIKIMET TEKNIKE-

Kërkesat teknike:

- Numri i automjeteve motorrike që do të jenë objekt shërbimi mirëmbajtjeje është 174 copë.
- Mjetet motorrike janë prodhim i viteve dhe modeleve të ndryshme (sipas preventivit bashkëlidhur).
- Mjetet motorrike për nga lloji i karburantit që përdorin janë me naftë, benzinë.
- Në preventiv parashikohen: difekte të konstatuara, mundësia e difektimit gjatë periudhës nga data e nënshkrimit të kontratës deri në përfundim të afatit 2 vjeçar dhe shërbime të tjera të domosdoshme për mirëmbajtjen dhe funksionimin e tyre.
- Pjesët e këmbimit të jenë të reja, teknikisht sipas standardeve të BE-së dhe të ambalazuara.
- Riparimet / mirëmbajtja e mjeteve nga ana e Operatorit Ekonomik, do të kryhet sipas kërkesave teknike dhe në përputhje të plotë me normat dhe standardet e miratuara për këtë qëllim.
- Riparimet / mirëmbajtja e mjeteve pranë Operatorit Ekonomik, do të kryhet në mënyrë periodike, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.
- Operatori Ekonomik ka detyrimin e kryerjes pa pagesë të shërbimeve të riparimit/ mirëmbajtjes që rezultojnë jo sipas kushteve teknike dhe afateve të garancisë, të përcaktuara në termat e referencës dhe specifikimet teknike, sipas afateve të kryerjes së shërbimit.
- Sipas sasisë dhe emërimit të pjesëve të këmbimit të përshkruar për çdo mjet në preventiv si dhe konform specifikimeve teknike të përshkruara, Operatori Ekonomik ka detyrimin e kryerjes së transportit të mjeteve, të cilat janë të difektuara dhe nuk kanë mundësi për vetëlëvizje, pranë servisit të autorizuar, nëpërmjet shërbimit me karrotrec dhe pa pagesë shtesë.
- Furnizimi i pjesëve të këmbimit dhe riparimi i automjeteve do të kryhet rast pas rasti sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor gjatë një periudhe 2 (dy) vjeçare nga hyrja në fuqi e marrëveshjes kuadër për një periudhë kohore dy vjet, sipas kërkesave dhe nevojave të Autoritetit Kontraktor.
- Kontraktori do të paguajë me shpenzimet e tij procesin e rritimit të mjeteve pranë Autoritetit të certifikuar për kolaudimin teknik të tyre nëse rezultojnë të ngelin në këtë proces për arsye që kanë të bëjnë me realizimin e kësaj kontrate.
- Në rast difektimi dhe pamundësisë për të dërguar mjetin për riparim/ shërbim, operatori ekonomik duhet të ofrojë për mjetet e OSSH sh.a shërbim karroatreci për transportimin e mjetit nga venddifektimi i mjetit në servisin e operatorit ekonomik për kryerjen e riparimit.

Preventivi bashkelidhur ne PDF.

Afatet e levrimit:

Furnizimi i pjeseve te kembimit dhe riparimi i automjeteve do te kryhet rast pas rasti sipas nevojave te Autoritetit Kontraktor gjate nje periudhe 2 (dy) vjecare nga hyrja ne fuqi e kontrates, duke ju referuar tabelës bashkelidhur ne PDF.

Pershkrim i procesit te riparimit te automjetit: Mjeti paraqitet ne servis nga drejtuesi i mjetit, nga ku mbahen shenim pretendimet e e tij nga pergjegjesi i servisit, me pas ne prani te grupi te punes te autorizuar te OSSH sh.a, behen verifikimet e problemeve te konstatuara nga stafi i servisit dhe hartohet nje akt konstatimi dhe preventiv me zerat perkates sipas pjeseve te kembimit te cilat kane nevojë te zevendesohen. Pasi grupi i punes i autorizuar OSSH jep miratimin per te bere riparimin e mjetit sipas zerave te hartuar ne preventiv, nis riparimi i mjetit i cili duhet te perfundoj brenda afateve te percaktuara ne tabelen me poshte. Gjate periudhes se riparimit grupi i punes ben verifikime te herepashershme prane servisit per te verifikuar ecurine dhe cilesine e riparimit te automjetit. Ne momentin e perfundimit te riparimit, personi pergjegjes i autorizuar prane servisit, njofton grupin e punes e autorizuar OSSH, per perfundimin e riparimit te mjetit ne menyre qe te behet terheqja e mjetit prane servisit. Grupi i punes i autorizuar nga OSSH sh.a bashke me drejtuesin e mjetit paraqitet prane servisit nga ku ben verifikimin e sherbimit te kryer dhe te pjeseve te nderruara sipas preventivit te miratuar, dhe nese pjeset e nderruara jane sipas preventivit te miratuar, hartohet nje procesverbal i perbashket ne tre kopje, ne prani te perfaqesuesit te autorizuar, drejtuesit te mjetit si dhe pergjegjesit te servisit. Pas firmosjes se proces verbalit drejtuesi i mjetit terheq automjetin nga servisi. Pjeset e vjetra te kembimit i dorezohen me procesverbal te vecante drejtuesit te mjetit i cili duhet ti beje hyrje ne magazinën e demontimit.

IV. Procedura operationale e riparimit te mjeteve

OSSH sh.a disponon rreth 174 mjete ne pronesine e saj, automjete te cilat kane te nevojshme servisimin e tyre, si per shkak te amortizimit qe vjen nga koha e perdorimit, por edhe per shkak te ngarkeses se punes. Riparimet e mjeteve kryhen nga Operatori Ekonomik i caktuar me ane te procedures se tenderimit dhe efektiviteti dhe efienca e ketyre riparimeve kontrollohen nga DSHM. Operatori Ekonomik fitues i procedures ka per detyre qe ne respektim te kushteve te kontrates se lidhur mes paleve te siguroje qe mjetet e OSSH sh.a te jene gjithmone ne gjendje pune, te gatshme per te perballuar te gjitha sfidat ne mbeshtetje te perpjekjeve te shoqerise per furnizimin sa me korrekt e me cilesi te konsumatoreve me energji elektrike ne mbare vendin.

Kontrata e mirembajtjes se automejteve ne pronesi te OSSH sh.a parashikon qe Operatori Ekonomik fitues te disponoje ne pronesi ose me qera nga pale te treta objekte me natyre perdorimi si servise makinash. Keto servise duhet te jene te lokalizuara ne Drejtorite Rajonale si me poshte:

DR Tirane
DR Fier
DR Shkoder
DR Korce

Servisimi i mjeteve motorike ndahet ne tre grupet e meposhtme:

Riparime periodike (nderrim vaji, filtra, ferota sic parashikohet ne preventivat perkates te kontrates)

Riparimet xhenerike per pasoje konsumi ose amortizimi (sic parashikohet ne preventivat perkates te kontrates)

Riparime kapitale (përfshijne nderhyrjet kapitale ne motor apo shasi, kur ato jane te nevojshme)

Hapat qe duhen te ndiqen ne menyre qe te kryhen servisimet e mjeteve ne respekt te kontrates por edhe te “Procedures operacionale te perdorimit te mjeteve motorike ne OSSH sh.a” po i paraqesim ne forme tabelare si me poshte:

Nr	Hapat e procesit	Etapat e servisimit te mjeteve		
		Riparime periodike	Riparime xhenerike	Riparime kapitale
1	Nga shefi i SHM te DR respektive lajmerohet Administratori i Kontrates per nevojen e servisimit te mjetit	√	√	√
2	Me ane te emailit ose shkreses zyrtare lajmerohet Operatori Ekonomik per mjetin qe do ti nenshtrohet procesit te servisimit	√	√	√
3	Pas futjes se mjetit ne servis nga ana e grupit te Punes dhe Operatorit Ekonomik pergatitet akt konstatimi dhe preventivi i cili dergohet per miratim prane Administratorit te Kontrates	√	√	√
4	Administratori i Kontrates vlereson zerat e preventivit, duke analizuar edhe historikun e mjetit dhe konfirmon/refuzon plotesisht ose pjeserisht preventivin e pergatitur. Konfirmimi/refuzimi do te behet vetem nepermjet kanaleve zyrtare email/shkrese	√	√	√
5	Pas marrjes se miratimit/refuzimi Operatori Ekonomik procedon me riparimet te cilat jane te konfirmuara	√	√	√
6	Afatet e riparimit te mjeteve	Max 2 dite pune	Max 5 dite pune	Max 30 dite pune
7	Operatori Ekonomik njofton Administratorin e Kontrates dhe/ose grupin e punes per perfundimin e procesit te riparimit	√	√	√
8	Administratorin e Kontrates dhe/ose grupi i punes ben verifikimin ne terren per cilesine e sherbimeve dhe sasine e zerave te miratuar ne preventiv	√	√	√

9	Pas verifikimit dhe kontrollit te zerave te preventivit hartohen dokumentet per marrjen ne dorezim te mjetit Akt -Verifikimi dhe PV Marje ne Dorezim	√	√	√
10	Operatori Ekonomik ploteson praktiken e faturimit dhe e dorezon ate te Administratori i Kontrates. Dorezimi i praktikës duhet te behet ne te njejtin muaj ne te cilin ka ndodhur procesi i servisimit.	√	√	√

Dokumentacioni shoqerues per faturat e leshuara nga Operatori Ekonomik i riparimit te mjeteve motorike te OSSH sh.a:

- Akt konstatimi dhe Preventiv i miratuar nga Administratori i Kontrates
- Kerkesa per riparim dhe Situacioni firmosur nga Administratori i Kontrates
- Akti i Verifikimit te kryerjes se punimeve firmosur nga Administratori Kontrates/Grupi Punes.
- Procesverbali marrjes ne dorezim firmosur nga Administratori Kontrates/Grupi Punes dhe perdoruesi i mjetit.
- Certifikata e garancise konfirmuar nga Administratori i Kontrates.
- Fatura tatimore Administratori i Kontrates.

Afati i garancisë së Pajisjeve / Pjesëve të këmbimit:

Pajisjet/ Pjesët e këmbimit duhet të ofrohen sipas afateve të garancisë të dhëna nga prodhuesi i automjetit ose nga distributorë të autorizuar nga prodhuesi i automjetit.
 Periudha e garancisë së pjesëve që do të zëvendësohen duhet të jetë perkatesisht 6 muaj per sherbimet periodike dhe 12 muaj per cdo ze tjeter, gjatë së cilës operatori ekonomik do të sigurojë riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin e saj pa pagesë konform specifikimeve teknike. Operatori ekonomik do të marrë përsipër zëvendësimin e çdo pjese të mjetit në rast difekti që vjen nga prodhuesi për një periudhë 1 vjeçare nga dita e furnizim vendosjes së mallit.

** Në respektim të LPP-së në të gjitha rastet kur përmendet “markë”, pranohet termi “ose ekuivalent i tij/i saj”.*

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: “Shërbim i mirmbajtjes së mjeteve motorike në pronesi të OSSH sh.a, me afat 2 vjeçar”.

Afati kohor i ofrimit të shërbimit është parashikuar për një periudhë kohore prej 2 (dy) vjet, duke nisur nga data e lidhjes së marrëveshjes kuadër.

Afati i shërbimit për secilin mjet: Brenda ditës dhe për shërbime të veçanta edhe më i gjatë.

Shënim: Pas identifikimit të nevojave, për procedurën e prokurimit, kërkesat për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, lista e cmimeve dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, për objektin e prokurimit, janë rishikuar dhe hartuar nga Grupi i punës/struktura e posaçme e përbërë nga specialistë të fushës, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40 dhe 74 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), për përmbushjen e qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen nga Autoriteti Kontraktor. (specifikisht për secilin zë të preventivit është vendosur emërtimi Furnizim-Venndosje).

Lista e shërbimeve: Bashkëlidhur ne PDF

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: “Shërbim i mirëmbajtjes së mjeteve motorike në pronësi të OSSH sh.a, me afat 2 vjeçar”

Objekti: Ka për objekt Shërbimin e mirëmbajtjes së mjeteve të OSSH sh.a ku në total janë 174 automjete.

Shërbime që kërkohen:

- 1) Riparime profilaktike (pjesët e ndërrimit që zëvendësohen me kohë përdorimi),
- 2) Riparime defektesh (zëvendësim pjesë ndërrimi të konsumuara),
- 3) Riparime të përgjithshme (kthimi në parametrat fillestar).

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkuar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e

drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

2.1.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me **Licencën e kategorisë VII.3.B.1, “Riparimi dhe mirembajtja e pjeseve mekanike dhe te motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për pikat a, b, c, ç, d** në përputhje me legjislacionin, për lejet dhe licencat, si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, me nr.1546, datë 29.03.2016, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për ambientin ku ushtron këtë aktivitet.

2.1.3 Operatori ekonomik ofertues, në lidhje me repartin e bojatisjes së mjeteve, duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore **të tipit B, Kodi III.1.B**, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për vendin ku ushtron këtë aktivitet.

Shenim : Nëse Operatori Ekonomik, nuk disponon ne pronesi ambient per repartin e bojatisjes por e siguron kete sherbim nepermjet kontrates se bashkepunimit, duhet të marrë përsipër, nëpërmjet një vetdeklarate, se do të kryerjë, me shpenzimet e veta, transportin e mjeteve për të gjitha shërbimet e kërkuara në shtojcën 6.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2 Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit 2022, 2023, 2024, të konfirmuara me vulë pranë administratës tatimore. Operatorët Ekonomikë të cilët plotësojnë 2 nga 3 kërkesat e germës “c” të nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" të ndryshuar; krahas bilanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vertetim nga organet e pushtetit lokal (Komuna / Bashkia) për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2024 (për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et sekondare), ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar (**të vitit 2025**) sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia ose Komuna në të cilën është regjistruar sipas QKB-se.

.
**** Ky kriter të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas Shtojcës përkatëse të DST. Ndërsa Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/et lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në Shtojcën përkatëse të DST.*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit të limit të kontratës objekt prokurimi.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik në pronësi/ose me qera pajisjet dhe instrumentet minimale të nevojshme për zbatimin e kontratës si më poshtë:

- mbi 8 (tetë) ura ngritese per automjetet (me kapacitet jo me pak se 3 Ton)
- 6 (gjashtë) ura ngritese per furgonat (me krah te gjate) me kapacitet jo me pak se 4ton
- 2 gropa per mjetet e renda (kamjona, autovinça, fadroma).
- 1 Linje kontrolli per kamjona (kontroll sistemit frenimit, amortizimit, konvergences)

-
- 2 linja kontrolli teknik te paisur me ure perkatese per ngritje dhe kontroll te mjetit
 - 2 (dy) paisje diagnostikuese te difektit ne automjet.
 - 2 (dy) paisje per kontrollin dhe testimin e sistemit frenimit te automjetit
 - 2 (dy) paisje per kontrollin dhe testimin e sistemit te amortizimit te automjetit.
 - 2 (dy) paisje per kontrollin dhe testimin e difekteve (xhokove) ne sistemin e drejtimit.
 - 2 paisje per zmontimin dhe montimin e gomave ne diskun e rrotes se automjetit.
 - 2 paisje per kontrollin & balancimin e disqeve & gomave automjetit (ballancim i rrotave).
 - 2 pajisje te levizshme (portabile) per ndezje emergjente te mjetit 12v & 24v.
 - 1 (nje) paisje bango prove per motorrine dhe dinamo
 - 2 (dy) paisje per kontrollin dhe komprimimin e gazit te A/C
 - 1 (nje) paisje per rregullimin e ndricimit te automjeteve
 - 1 (nje) paisje per kontrollin dhe testimin e gazrave te automjeteve
 - 1 (nje) paisje per sistemin e kontrollit dhe dedektimin te rrjedhjes se systemit te ftohjes te automjetit (Radiatori dhe Pjeseve perberese te tij)
 - Pajisje per kontrollin ne presion te testates dhe cilindrit te motorrit
 - Pajisje per pastrimin nga brenda e motorrit me H2
 - Pajisje per pastrim te partikularit dhe marmides katalitike (pastrimi DPF)
 - 1 (nje) paisje per saldim me oksigjen dhe acitilen
 - 1 (nje) paisje per saldim me argon
 - 1 (nje) paisje per saldim me elektrik
 - 2 (dy) paisje per kontrollin dhe realizimin e gjeometrise (konvergjences) rrotave te mjetit te kompletuara perkatesisht me urat me kater kollona te pershtatshme ne kapacitet per fuoristradat dhe furgonat sipas listes automjeteve referuar specifikimeve ne DT.
 - Te kete repart te riparimit karrocere se automjetit (shasisë, tapicerise dhe perpunimit te llamarines) si dhe bojatisjes se mjetit te pajisur me :
 - a) 1(nje) furre per lyerje me kapacitet per mjetet fuoristrada dhe furgona
 - b) 1 (nje) furre per lyerje me kapacitet per kamjona, repartin per pergatitjen paraprake
 - c) 1 (një) pajisje per drejtim shasisë te cilat te kene kapacitet ne pershtatje te plote per realizimin e sherbimeve te mjeteve sikurse kerkohet ne specifikimet teknike
 - d) Reparti te jete i kompletuar me pajisjet perkatese (pajisjes poter per drejtim llamarine, puntatrice, aparat saldimi, stukimi, pajisje zmerilimi dhe lucidimi)

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet: Dokumentacion për pajisjet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimit / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi/ çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

- Fotografi te pajisjeve te mesiperme te cilat kerkohen te jene te montuara ne servis si dhe te paraqiten kataloget/fragmente katalogu perkates te pajisjeve te cilat disponon aktualisht ne servis.

Lidhur me kërkesat e vendosura në këto kriter kemi parasysh që të gjitha pajisjet e kërkuara me sipër, janë në përputhje të plote me specifikimet teknike dhe në funksion të shumëllojshmërisë së zërave të riparimit dhe shërbimeve si dhe të sasisë së automjeteve të kërkuara në DT.

Kriteri 2.3.2 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të provojë se ka në dispozicion, apo mund t'i vihet në dispozicion, **minimalisht 2 (dy) karrotrëce**, për transportimin e automjeteve të difektuara, për të cilin duhet të paraqesë dokumentat:

a) Dokumentacioni që vërteton pronësinë ose marrjen me qera:

- Dokumentacioni që vërteton pronësinë: Çertifikata e pronësisë, e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj / Kontrata e shitblerjes / Kontrata e dhurimit / Çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë, sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
- Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira: Kontratë qiraje.

b) Leje qarkullimi e mjetit;

c) Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore;

d) Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve rrugore.

e) Certifikatë për transport mallrash (e detyrueshme vetëm për mjetet me kapacitet transportues mbi 1.5 ton);

Për sa më sipër operatori ekonomik të paraqesë një deklaratë perkatese sipas formatit të mëposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtes	Statusi
1				Pronesi/qira/perdorim

Kriteri 2.3.3 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në pronësi ose me qera në përdorim të ambjenteve për ushtrimin e aktivitetit të tij (lidhur me riparimin e automjeteve) në zonat ku ndodhen Drejtorite perkatese të OSSH-sha, TIRANË, SHKODËR, KORÇË, FIER.

Për sa më sipër operatori ekonomik të paraqesë një deklaratë perkatese sipas formatit të mëposhtem:

Nr.	Vendodhja	Statusi
1		Pronesi/qira/perdorim

Operatorët ekonomikë për ambientin që ushtron aktivitetin duhet të paraqesin pranë AK përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimimit, dokumentacion që vërtetojnë pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Dokument që vërteton pronësinë, ose huapërdorjen, ose qiramarrjen si më poshtë:

➤ *Dokumentacioni që vërteton pronësinë:*

- Çertifikata e pronësisë, e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose
- kontrata e shitblerjes; ose
- kontrata e dhurimit; ose
- çdo dokument tjetër, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë, sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

➤ *Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:*

- Kontratë huaje.

➤ *Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:*

- Kontratë qiraje.

Për të përmbushur këtë kriter, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponueshmërinë e hapesirave në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme të cilësisë:

a) Standardin **ISO 9001:2015** ose ekuivalent (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

b) Standardin **ISO 14001:2015** ose ekuivalent (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të mjedisit, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme), dhe të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

c) standardin **ISO 45001:2018** ose ekuivalent, (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të cilësisë veçanërisht për sektorin e automobilave, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme), dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i

akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

2.3.6

